

## **Projekti KSV 019 Asistenca Teknike në Kontekst të Integritimit Evropian i financuar nga Qeveria e Luksemburgut**

### **Ftesë**

Projekti “KSV 019 Asistenca Teknike në kontekst të Integritimit Evropian“ njofton të gjithë shërbyesit civil të interesuar të cilët i plotësojnë kushtet e parapara sipas rregullativës së zbatimit të projektit dhe Planit të Kapaciteteve, që të aplikojnë për realizimin e hulumtimit për **“Buxhetimi i bazuar në programe”**<sup>1</sup>.

Qëllimi i hulumtimit është të elaborojë buxhetimin programor me fazat e tij, dallimet në përgatitje dhe zbatim të ciklit buxhetor me këtë metodologji krahasuar me buxhetimin aktual, parakushtet për buxhetim programor dhe të nxirren rekomandime për implikimet e mundshme nga kalimi në këtë metodologji të përgatitjes së buxhetit të cilat mund të ndihmojnë politikë-bërësit në përgatitjet e kapaciteteve dhe diskutimet lidhur me këtë reformë.

Kushtet për aplikim janë:

- Të jeni shërbyes civil;
- Të keni përvojë relevante së paku 5 vjeçare lidhur me menaxhimin financiar përfshirë edhe në kontekst të kërkesave të procesit të integritimit evropian dhe procesit buxhetor;
- Të keni njohuri të gjuhës angleze, në veçanti kompetencë profesionale në të shkruar;
- Të pranoni kushtet lidhur me të drejtat e publikimit dhe shfrytëzimit të hulumtimit.

Propozimi për hulumtim duhet të përmbajë së paku këto elemente të organizuara në një strukturë adekuate: një hyrje, përshkrim të strukturës së hulumtimit që propozohet, informacion për metodologjinë që do të përdoret dhe një plan të punës (1-2 paragrafë) që elaboron shkurtimisht fazat kryesore të realizimit të hulumtimit të shoqëruar me të dhënat bazë të kandidatëve që aplikojnë (emri dhe mbiemri, pozita, emri i institucionit). Kushtet specifike do të përcaktohen në marrëveshjen e hulumtimit e cila do të ofrohet nga projekti për kandidatët e suksesshëm.

Lejohet edhe aplikimi në bashkë-autorësi, por duhet specifikuar se kush është autori i parë dhe ndarja e punës midis autorëve përmes numrit të ditëve. Propozimi nuk mund të tejkalojë numrin maksimal prej 20 ditëve të angazhimit. Të gjithë shërbyesit civil të interesuar duhet të dërgojnë propozimin për hulumtim dhe një cv në adresën [renea.bula@rks-gov.net](mailto:renea.bula@rks-gov.net) dhe [Jeton.karaqica@rks-gov.net](mailto:Jeton.karaqica@rks-gov.net) më së largu deri me datë 10 Mars 2023 në ora 16:00.

---

<sup>1</sup> Në original: Program-based Budgeting